

Dalës-izlazna

Nr. —1—26 Data 01.03.2023  
Br. Datum

OBILIC-OBILIC



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



## RREGULLORE (KO) Nr.02/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT

Obiliq, 2023

## KUVENDI I KOMUNAL OBILIQ

Në pajtim me nenin 12, paragrafi, 12.2 pika c dhe nenin 17 pika f, të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës*”, nr. 28/2008), nenet 15 paragrafi 7 dhe 34 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L – 60, për Mbeturina, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 Për Mbeturina, në nenin 8 pika a, nenin 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 37 paragrafi 1.6, nenin 38 paragrafi 1.3, nenin 44 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 datë 25.04.2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2023, miraton:

### RREGULLORE (KO) Nr.02/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E OBILIQIT

#### Neni 1

#### Dispozitat e Përgjithshme

Kjo rregullore përshkruan përbajtjen e vendimit për mënyrën e ofrimit të shërbimit publik, mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në lidhje me shërbimin publik të mbledhjes së mbeturinave të përziera, mbeturinave të biodegradueshme komunale dhe mbledhjen e veçantë të mbeturinave të letrës, metalit, qelqit, plastikës, tekstilit, mbeturinat problematike dhe mbeturinat e vëllimshme, shpërndarja hapësinore e pikave të riciklimit, metoda e llogaritjes së sasisë së mbeturinave të përziera komunale për periudha të caktuara kohore, mënyra dhe kushtet e përcaktimit dhe llogaritjes së tarifës për pagesën e mbeturinave komunale për amvisëri dhe biznese.

#### Neni 2

#### Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregulloj sistemin e menaxhimit të mbeturinave komunale, tarifën për shërbimin e grumbullimit tëmbeturinave dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm finansiar në Komunën e Obiliqit.

#### Neni 3

#### Fushëveprimi

Kjo Rregullore definon kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave (zvogëlimin e sasisë së deponuar, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, deponimin dhe aktivitetet e riciklimit) me qëllim të ruajtjes së mjedisit.

#### Neni 4

#### Përkufizimet

1. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.
2. **Menaxhimi i mbeturinave** – nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin,

transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;

3. **Gjeneruesi i mbeturinave** - subjekt fizik apo juridik i cilësuar si krijuesi i mbeturinave.
4. **Operatori** – nënkuption personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve;
5. **Ministria** – nënkuption Ministrinë përkatëse për mjedisin;
6. **DMM** – Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Obiliqit;
7. **DSHPE** – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë – Komuna e Obiliqit;
8. **Licenca për menaxhimin e mbeturinave** - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjeve ne fuqi;
9. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhim të mbeturinave;
10. **Konsumatori** – person i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara;
11. **Ri-përdorimi** - çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar;
12. **Mbledhja** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri të objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;
13. **Mbledhja e ndarë** - nënkuption mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet ne mënyrë te ndare në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;
14. **Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;
15. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
16. **Mbeturinat komunale** – nënkuption:
  - 15.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet;
  - 15.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tillë janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;
  - 15.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit;
17. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;
18. **Mbeturina komerciale** - nënkuption mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen

- mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;
19. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:
    - a) Mbeturina inerte qe nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
    - b) I tërë kullimi dhe përbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksiqe duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
  20. **Mbeturinë e vëllimshme** – mbeturinatme përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë;
  21. **Qendër grumbulluese** – lokacioni për pranimin përkatesisht grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara nga qendra;
  22. **Pikë grumbulluese** – lokacioni ku janë të vendosur shportat, kontejnerët dhe qeset/thasët për grumbullimin e mbeturinave komunale;
  23. **3R** – reduktim, ripërdorim, reciklim.

#### **Neni 5 Përjashtimet**

1. Nga kjo Rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
  - a. Mbeturinat e rrezikshme,
  - b. Mbeturina medicinale, dhe
  - c. Lumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme.
2. Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të udhëzimeve të veçanta administrative përkatëse të ministrisë.

#### **Neni 6 Përgjegjësitë e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave**

1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
3. Procesi i kontraktimit për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
4. Themelimi i sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, në kuadër të DSHPE-sëqë të planifikojë, rregullojë, udhëheqë dhe zbatoj planin komunal të menaxhimit të mbeturinave, si dhe të udhëzojë, monitoroj ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
5. Menaxhimi i mbeturinave komunale nga ndërtim – demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, dhe të vëllimshme.
6. Përcaktimi i lokacionit për qendrën grumbulluese për mbeturinat e vëllimshme, dhe mbeturinat elektrike dhe elektronike.
7. Pas sigurimit të lokacionit për hedhjen e mbeturinave inerte, do të bëhet vendosja e kontejnerëve për mbeturina inerte në të gjitha vendbanimet.

8. Përcaktimii lokacioneve për vendosjen e shportavedhe kontejnerëve komunal.
9. Përcaktimi i llojittë kontejnerëve të përshtatshëm me teknikën me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i tyre.
10. Përcaktimi dhe publikimi i orarit dhe dinamikëssë mbledhjes së mbeturinave në marrëveshje me operatorin.
11. Sipas nevojës, autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë.
12. Identifikimi i pikave ilegale të mbeturinave dhe eliminimi i tyre.
13. Sektori për menaxhim të mbeturinave shqyrton ankesat e klientëve sa i përket shërbimit të grumbullimit të mbeturinave përmes komisionit përkatës.
14. Sigurimi i kushteve të veprimit dhe operimit për operatorin.
15. Përcaktimi i tarifave dhe mënyra e inkasimit.
16. Promovimi i konceptit për minimizimitë mbeturinave - 3R.
17. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave komunale.
18. Përpilimi i raporteve mbi menaxhimin e mbeturinave.
19. Hartimi dhe dorëzimi i raportit vjetor në Ministri bazuar në ligjet në fuqi.
20. Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme, gjashtë (6) herë në vit, çdo dy muaj, pa pagesë.

**Neni 7  
Përgjegjësitë e Operatorit**

Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është i obliguar që të veproj sipas marrëveshjes së nënshkruar dhe ligjeve në fuqi.

**Neni 8  
Të Drejtat dhe Detyrat e Gjeneruesve të Mbeturinave**

1. Çdo gjenerues i mbeturinave obligohet të kyçet në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;
2. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen:
  - a) Amvisëritë të cilave ju shërbehet derë me derë , mbeturinat duhet ti ndajnë dhe ti vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna;
  - b) Në banimet kolektive ku shërbimi bëhet në pikë grumbulluese me kontejner, mbeturinat duhet ti ndajnë dhe ti vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
3. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankesë ndaj shërbimit të ofruar;
4. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme;
5. Çdo gjenerues duhet të paraqesë ndryshimin e të dhënave (p.sh. shitja e pronës, trashëgimia, dëshmitë dhe dokumentet tjera të përditësuara);
6. Gjeneruesit e mbeturinave duhet të regjistrohen në regjistrin e shërbimeve të konsumatorëve për mbeturina, regjistrimet e reja të amvisërive(gjeneruesve) në sistemin e të dhënave të bëhen në bazë të kushteve si mëposhtë:
  - a. Kontrata e shitblerjes;
  - b. Blerësi regjistrohet në sistem të të dhënave, nëse nuk është i regjistruar

- paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontratës, derisa shitësit i ndryshohet vetëm adresa;
- c. Regjistrimi i njehsorit të energjisë elektrike;
  - d. Konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina në vendbanimin paraprak;
  - e. Dokumenti identifikues.
7. Çdo gjenerues duhet të bashkëpunojë me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër;
  8. Ndërmarrjet prodhuase të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës t’ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimitarës;
  9. Çdo gjenerues obligohet që ti largojë mbeturinat që krijojen gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, nga hapësirat ose vendet publike;
  10. Shërbimet e veçanta, (largimi i mbeturinave të vëllimshme, dhe mbeturinave të tjera që nuk largohen gjatë shërbimit të rregullt), bëhen me pagesë, përveç shërbimeve sipas nenit 4 pika 4.19;
  11. Bizneset të cilat ushtrojnë veprimitari të ndryshme janë të obliguar që tambajnë të pastër hapësirën para objektit dhe përreth tyre.

## Neni 9

### Kategorizimi i Gjeneruesve të Mbeturinave

1. Gjeneruesit e mbeturinave ndahen në kategoritë si më poshtë:
  - a. **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak - amvisëritë:**
    - i. **Nënkatgoria e parë:** konsumatorët e shërbyer derë me derë - zona urbane dhe zona rurale.
    - ii. **Nënkatgoria e dytë:** konsumatorët e shërbyer me kontejnerë tëpërbashkët – zona urbane dhe zona rurale;
  - b. **Kategoria e konsumatorëve Komercial/Industrial:**
    - i. **Nënkatgoria e parë:** veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese. Në këtë kategori bëjnë pjesë këto veprimitari të bizneseve:kioska, kafe pjekëse shitore, shitës të CD-ve dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjencione turistike, avokatura, video lojërat, video klub, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtarë, dyqan fotografish, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurë gdhendës, saraç-mbathtarë, zyra e inkasimit, OJQ, shitore suvenirësh, këmbimore, auto parking, butik, librari, llamarine punues, axhustator, kurse të gjuhëve dhe IT- së;
    - ii. **Nënkatgoria e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të ulët të shërbimit. Në këtë nënkatgori bëjnë pjesë këto veprimitari të bizneseve: auto larje, frizer meshkujsh dhe femrash,ëmbëltore, shitore tekstili, shitore të auto-pjesëve, hekurishte, shitore sanitare, sallon i vogël i mobileve, shitore këpucësh, servise të ndryshme (elektroteknike dhe TI), shitore të ndryshme, objekte fetare të vogla, zyra të partive politike, farmaci, zyrat postare e të ngjashme, bastore, klinike (ordinance private), ordinance stomatologjike deri ne dy karrige, automekanik, auto electricist, auto saldues, auto sallon, dhe byrektore;
    - iii. **Nënkatgoria e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me

kosto të moderuar të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve:furra të bukës dhe byrektore, kafeteri, minimarket - shitore ushqimore, podrumë të pijeve, poliklinike, filiale të bankave, sallone të sanitarisë, sallon i madh mobiliesh, qendrat sportive e të ngjashme), qendra te fitnesit, auto ngjyrosësh, fastfood, bujtina, pompa te benzinës, xhamprerëse, dhe ordinance stomatologjike mbi dy karrige.

- iv. **Nënkategori e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të lartë të shërbimit. Në këtë nënkategori bëjnë pjesë këto veprimtari të bizneseve: gjellëtore, restoran-qebaptore, restorante, fastfood, diskoteka, hotele, motele, dhe pompa te benzinës me restorant.
- v. **Nënkategori e pestë:** subjektet komercial/industrial të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë  $1.1\text{m}^3$  dhe  $7\text{m}^3$ . Në këtë nënkategori bëjnë pjesëtë gjithë subjektet komercial/industrial të cilët kanë hapësirë që brenda pronës së tyre të vendosin kontejnerë  $1.1\text{ m}^3$  dhe  $7\text{m}^3$ .

- c. **Kategoria e konsumatorëve institucional.** Konsumatorët në këtë kategori do të shërbehen më kontrata të veçanta me kontejnerë  $1.1\text{ m}^3$  dhe  $7\text{ m}^3$ .

Kategoria e konsumatorëve institucional ndahet në:

(1) nënkatgorinë e konsumatorëve të institucioneve komunale; dhe (2) të konsumatorëve të institucioneve të nivelit qendror. Në nënkatgorinë e konsumatorëve të institucioneve komunale bëjnë pjesë: shkollat fillore dhe të mesme, institucionet parashkollore, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, bashkësítë lokale, zyret e vendit, objektet e komunës, teatri, kinemaja, objektet kulturore, objektet sportive,zjarrfikësit dhe bashkësítë fetare.Në nënkatgorinë e konsumatorëve të institucioneve qendrore dhe organizatave ndërkombëtare bëjnë pjesë:institucionë shëndetësore publike dhe private, Policia e Kosovës, ndërmarrjet publike, posta, gjykata, agjencionet e pavarura, dhe qendra për punë sociale.

## Neni 10

### Tarifa për Grumbullim, Transportim, dhe Deponim të Mbeturinave

1. Kategoritë e konsumatorëve do të paguajnë faturë mujore për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave si në vijim:

- 1.1 **Kategoria e konsumatorëve shtëpiak – amvisëritë do të paguajnë tarifë fiksë prej **4.70 € (euro)** në muaj.**

1.1.1 Banorët jo-rezident (diaspora) obligohen ti kryejnë detyrimet financiare ndaj kompanisë **15 € (euro)**përnjë vit kalendarik.

- 1.2 **Kategoria e konsumatorëve Komercial/Industrial.**

1.2.1 **Nënkategori e parë:** veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese do të paguajnë tarifëfiksë prej **5.30 € (euro)** në muaj.

1.2.2 **Nënkategori e dytë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të ulët të shërbimit do të paguajnë tarifë fiksë prej **9.20 € (euro)** në muaj.

1.2.3 **Nënkategori e tretë:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të moderuar të shërbimit do të paguajnë tarifëfiksë prej **12.8 € (euro)** në

muaj.

- 1.2.4 **Nënkategori e katërt:** subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të lartë të shërbimit do të paguajnë tarifë fikse prej **24.0 €** (euro) në muaj.
- 1.2.5 **Nënkategori e pestë:** subjektet komerciale/industriale të shërbyer me kontrata të veçanta, konkretisht me kontejnerë **1.1m<sup>3</sup>** dhe **7m<sup>3</sup>**, do të paguajnë tarifë prej **12.0 €** (euro) për një zbrasje për kontejnerë **1.1m<sup>3</sup>**, dhe **36.8 €** (euro) për një zbrasje për kontejnerë **7m<sup>3</sup>**.
- 1.3 **Kategoria e konsumatorëve institucional** do të paguajnë tarifë fikse prej **12.0€** (euro)për një zbrasje për kontejnerë **1.1m<sup>3</sup>**, dhe **36.8 €** (euro) për një zbrasje për kontejnerë **7m<sup>3</sup>**.
2. Shkalla e tarifës mund të rishikohet çdo dy vitenga Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit.

### **Neni 11** **Veprimet e Ndaluara dhe Gjobat**

1. Me gjobë në vlerë prej njëzet (20) Euro deri në pesëqind (500) Euro, dënohet për kundërvajtje çdo person fizik për veprimet me mbeturina që shkaktojnë ndotjen e mjedisit dhe dërmtojnë shëndetin e njeriut, si në vijim:
  - 1.1. me gjobë në vlerë prej njëzet (20) Euro i shqiptohet ndëshkimi personitnëse:
    - 1.1.1. hedhë cigaren në rrugë ose në sipërfaqe publike;
    - 1.1.2. hedhë çamçakëz në rrugë ose në sipërfaqe publike;
  - 1.2. me gjobë në vlerë prej tridhjetë (30) Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
    - 1.2.1. hedhë ambalazhe dhe mbeturina letre në rrugë ose në sipërfaqepublike;
    - 1.2.2. hedhë ambalazhe dhe mbeturina plastike në rrugë ose nësipërfaqe publike;
    - 1.2.3. hedhë ambalazhe dhe mbeturina qelqi dhe metali në rrugë osenë sipërfaqe publike;
    - 1.2.4. hedhë kanaçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;
    - 1.2.5. hedhë mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;
    - 1.2.6. hedhë çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike.
  - 1.3. me gjobë në vlerë prej katër dhjetë (40) Euro i shqiptohet ndëshkimipersonit nëse:
    - 1.3.1. hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturinakomunale;
    - 1.3.2. në kontejner të mbeturinave, merr ose shkapërderdh – nxjerrmbeturina prej kontejnerit jashtë;
    - 1.3.3. hedhë mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuar mbeturinat si:
      - 1.3.3.1. organike, qelqi, letra, plastika, metali,
      - 1.3.3.2. mbeturinat nga copëtimi dhe prerja i drunjëve, i lenënë rrugë ose në sipërfaqe publike;
      - 1.3.3.3. mbeturinat nga thëngilli, i len në rrugë ose në sipërfaqepublike;
      - 1.3.3.4. nuk e pastron jashtëqitjen e kafshës së tyre në rrugë, trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv, hapësira dhe objekte tjera publike.

1.4. me gjobë në vlerë prej pesëdhjetë (50) Euro i shqiptohet ndëshkimipersonit nëse:

- 1.4.1. hedhë cigare në rrugë nga automjeti në lëvizje;
  - 1.4.2. hedhë ambalazhe dhe mbeturina letre në rrugë nga automjetinë lëvizje;
  - 1.4.3. hedhë ambalazhe dhe mbeturina plastike në rrugë nga automjetinë lëvizje;
  - 1.4.4. hedhë ambalazhe dhe mbeturinë qelqi në rrugë nga automjetinë lëvizje;
  - 1.4.5. hedhë kanaçe në rrugë nga automjeti në lëvizje;
  - 1.4.6. hedhë mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;
  - 1.4.7. dëmton kontejnerët për mbeturina komunale;
  - 1.4.8. i ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
  - 1.4.9. hedhë akumulatorë në kontejnerët për mbeturina komunale;
  - 1.4.10. hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët përbeturina komunale;
  - 1.4.11. hedhë mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët përbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërsaqe publike;
  - 1.4.12. hedhë ambalazhe dhe mbeturina letre në natyrë;
  - 1.4.13. hedhë ambalazhe dhe mbeturina plastike në natyrë;
  - 1.4.14. hedhë ambalazhe dhe mbeturina qelqi në natyrë;
  - 1.4.15. hedhë kanaçe në natyrë,
  - 1.4.16. hedhë mbeturina ushqimore në natyrë;
  - 1.4.17. hedhë mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturinakomunale;
- 1.5. me gjobë në vlerë prej shtatëdhjetë (70) Euro i shqiptohet ndëshkimipersonit nëse:
- 1.5.1. hedhë çfarëdo lloj mbeturin nga ballkoni ose dritarja e objektit;
  - 1.5.2. hedhë mbeturina në pusetat për kanalizim;
  - 1.5.3. hedhë mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtëkontejnerëve (ambalazhë letre, metali, plastike dhe materiale tëndryshme);
  - 1.5.4. hedhë mbeturina të ngjyrave në kanalizim;
  - 1.5.5. hedhë mbeturina të ngjyrave në kontejner për mbeturinakomunale;
  - 1.5.6. hedhë mbeturina të vajit në tokë nga pakujdesia;
  - 1.5.7. hedhë mbeturinat medicinale në kontejner për mbeturinakomunale;
  - 1.5.8. hedhë mbeturina të stallave në afersi të rrugës brendavendbanimit (nuk nënkupton shpërndarjen e plehut në ara);
  - 1.5.9. hedhë mbeturina në pronën e tjetrit;
  - 1.5.10. hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në sipërsaqe publikeose në natyrë;
  - 1.5.11. hedhë bateri ose akumulator në sipërsaqe publike ose nënnatyrë;
  - 1.5.12. hedhë cigaren e ndezur në kontejnerin për mbeturina komunale;
  - 1.5.13. hedhë hirin e nxehëtë në kontejnerin për mbeturina komunale;
- 1.6. me gjobë në vlerë prej dyqind (200) Euro i shqiptohet ndëshkimi personitnëse:
- 1.6.1. hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeveose kontejnerëve të caktuar nga autoriteti komunal për mbeturina tëmaterialeve ndërtimore;
  - 1.6.2. hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore në kontejnerët përbeturina komunale;
  - 1.6.3. hedhë mbeturina medicinale në sipërsaqe publike ose në natyrë;
  - 1.6.4. hedhë mbeturina medicinale jashtë kontejnerëve për këto llojetë mbeturinave;
  - 1.6.5. hedhë mbeturina të vëllimshme në kontejner për mbeturinakomunale,

- sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.6. hedhë lloj tjetër të mbeturinave në sipërfaqe publike ose nënnatyrë;
  - 1.6.7. hedhë mbeturina të përziera me vaj në kontejnerët për mbeturinakomunale;
  - 1.6.8. mbeturinat drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve nuk imbledh nga rruga ose hapësira publike në kohën e krasitjes;
  - 1.6.9. hedhë mbeturina drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve nëkontejnerët për mbeturina komunale;
  - 1.6.10. djegë mbeturina komunale në kontejner;
  - 1.6.11. hedhë broshura, fletëpalosje jashtë vendeve të përcaktuaranga komuna.
- 1.7. me gjobë në vlerë prej pesëqind (500) Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
- 1.7.1. hedhë çfarëdo lloj mbeturine në ujëra të përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
  - 1.7.2. hedhë çfarëdo lloj mbeturine në brigjet e përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
  - 1.7.3. hedhë mbeturina të vajit në sipërfaqe publike, kanalizim, nërrugë ose në natyrë;
  - 1.7.4. hedhë mbeturina të përziera me vaj në sipërfaqe publike, nërrugë ose në natyrë;
  - 1.7.5. hedhë mbeturina të gomës dhe goma të automjeteve nësipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 1.7.6. djegë mbeturina komunale në sipërfaqe publike, në rrugë osenë natyrë;
  - 1.7.7. djegë goma, goma të automjeteve ose mbeturina tjera prejgome, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 1.7.8. djegë mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 1.7.9. djegë mbeturina të ndryshme prej letre në sipërfaqe publike, nërrugë ose në natyrë;
  - 1.7.10. djegë vajra ose mbeturina të vajrave në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 1.7.11. djegë mbeturinat të ndryshme në sipërfaqet e tokave bujqësore.
  - 1.7.12. derdhë çfarëdo materiali në sipërfaqe publike, në rrugë ose nënnatyrë me ç ‘rast prej saj krijohet mbeturinë ose ndotje.

**Neni 12**  
**Dispozitat Ndëshkuese**

1. Ndaj gjeneruesit te mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina dhe i cili nuk i përbahet rregullores, do të iniciohet procedurë ligjore përmbaruese sipas ligjeve në fuqi, ne gjykatën kompetente.
2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave që kanë faturat të pa paguara për gjashtë (6) muajt e fundit, do te iniciohet procedurë përmbaruese.
3. Shumat e gjobave të cilat i shqipton inspektori i mjedisit me vendim dhe janë të

përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje dhe me akte ligjore dhe nënligjore të ministrit të Ministrisë.

- a) kundër vendimit të inspektorit të mjedisit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Neni 13**  
**Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

1. Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi.
2. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspepcion, dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.
3. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, Drejtoria e Inspepcionit dhe zyrtaret tjera të autorizuar nga ana e Komunës.
4. Për këtë rregullore njoftohet Ministriae Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

**Neni 14**  
**Hyrja në Fuqi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e Rregullores mbi administrimin e mbeturinave, pastrimin e rrugëve, shesheve dhe trotuareve në territorin e komunës me nr.I-145/1 datë 26.10.2022.
2. Kjo rregullore hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunal Obiliq  
Datë:28.02.2023

